

D E K R E T
Nr.1188, datë 10.8.1995

PËR POLICINË GJYQËSORE

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave

D E K R E T O J:

Neni 1

Policia gjyqësore ka për detyrë të marrë dijeni për veprat penale, të parandalojë ardhjen e pasojave të mëtejshme, të zbulojë autorët e tyre, si dhe të kryejë veprime hetimore për zbulimin e veprimtarisë kriminale, si me nismën e vet, ashtu edhe me urdhër, apo delegim të prokurorit.

Neni 2

Policia gjyqësore e realizon veprimtarinë e saj, nëpërmjet oficerëve dhe agentëve pranë strukturave të llojeve të ndryshme të policive ekzistuese, si dhe të çdo policie tjetër, që me ligjin e krijimit, i njihet një funksion i tillë.

Neni 3

Në strukturën ekzistuese të prokurorive të rretheve, krijohen seksione të policisë gjyqësore të cilat kanë për detyrë të hetojnë vepra penale që denoncohen drejtpërsëdrejti në prokurori, si dhe të tjera që u ngarkohen me urdhër të prokurorit.

Neni 4

Veprimtaria procedurale penale e oficerëve dhe agentëve të policisë të të gjitha strukturave kryhet nën kontrollin dhe sipas urdhrave e udhëzimeve të prokurorit dhe në përputhje të plotë me dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 5

Oficerët dhe agentët e policisë gjyqësore janë në vartësinë administrative të drejtuesve të strukturave të policisë ku bëjnë pjesë.

Neni 6

Prokuroria dhe gjykata nuk disponojnë administrativisht asnjë trup të strukturave të ndryshme të policisë, por shfrytëzojnë shërbimet e tyre për të kryer normalisht veprimtarinë hetimore dhe gjyqësore, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 7

Ministri i Brendshëm, ministri i Drejtësisë, ministri i Mbrojtjes si dhe titullarët e çdo strukture tjetër detyrohen të marrin masa, që oficerët dhe agentët e policisë gjyqësore, si dhe të shërbimeve të kësaj policie të inkuadruara në strukturat që varen prej tyre të zbatojnë urdhrat dhe udhëzimet e dhëna nga prokurori dhe gjykata në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

Neni 8

Kur e kërkojnë nevojat e hetimit, për shkak të specializimit të veçantë, me kërkesë të

prokurorit të Përgjithshëm, apo të Prokurorit të rrethit mund të komandohen pranë seksioneve të policisë gjyqësore të prokurorisë, oficerë dhe agjentë të policive gjyqësore, të strukturave të tjera në çdo rast me miratim dhe urdhër të titullarit të administratës përkatëse.

Neni 9

Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore të çdo strukture, gëzojnë statusin e ushtarakut. Titullimi dhe gradimi i tyre, bëhet me urdhër të titullarit të organit nga i cili varen administrativisht.

Neni 10

Emërimi, transferimi dhe largimi nga detyra e oficerëve dhe agjentëve të policisë gjyqësore të seksioneve pranë prokurorisë të rretheve, bëhet me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm.

Emërimi, transferimi dhe largimi nga detyra i oficerëve dhe agjentëve të policisë gjyqësore të strukturave të ndryshme të policisë, bëhet nga titullarët e këtyre strukturave, duke marrë më parë pëlqimin e Prokurorit të Përgjithshëm.

Neni 11

Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore duhet të jenë me arsim të lartë si rregull juridik, ose profesional, të mos kenë qënë të dënuar me heqje lirie, si dhe të kenë figurë të pastër morale.

Agjentët e policisë gjyqësore, mund të lejohen edhe me arsim të mesëm.

Neni 12

Për shkelje në ushtrimin e detyrës, si dhe të dispozitave të këtij dekreti, kur ato nuk përbëjnë vepër penale ndaj oficerëve dhe agjentëve të policisë gjyqësore pranë seksioneve të prokurorisë, si dhe ndaj atyre pranë strukturave të ndryshme të policisë, merren këto masa disiplinore:

1. Vërejtje.
2. Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra.
3. Pezullim nga detyra deri në gjashtë muaj dhe caktimi në një detyrë, që paguhet më pak.
4. Transferim deri në një vit.
5. Largim nga detyra.

Masat disiplinore jepen nga titullarët e prokurorisë të rretheve, për funksionarët e seksioneve të policisë gjyqësore të ngritura pranë tyre dhe nga titullarët e organeve përkatëse, për oficerët dhe agjentët e tjerë të policisë gjyqësore.

Për masat disiplinore të parashikuara nga pikat 4 dhe 5 kërkohet në çdo rast edhe miratimi i Prokurorit të Përgjithshëm.

Ankimi kundër vendimeve të dënimit për këto masa, mund të bëhet në gjykatën e shkallës së parë, brenda 10 ditëve nga marrja njoftim.

Neni 13

Ministri i Brendshëm, ministri i Drejtësisë, ministri i Mbrojtjes, Prokurori i Përgjithshëm, si dhe titullarët e strukturave të tjera policore, ngarkohen që në bazë dhe për zbatim të këtij ligji të nxjerrin urdhra dhe udhëzime.

Neni 14

Numri i oficerëve dhe agjentëve të policisë gjyqësore, si dhe pagat e tyre, caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të përbashkët të titullarëve nga të cilat varen.

Neni 15

Emërimi, titullimi dhe gradimi i oficerëve, i agjentëve të policisë në të gjitha strukturat,

krijimi i seksioneve të policisë gjyqësore pranë prokurorive, të përfundojë brenda 15.9.1995. Deri më këtë datë hetimet të vazhdojnë të kryhen nga strukturat që kanë qënë të ngritura para datës 1.8.1995

Neni 16

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

KUNDËRFIMOHETP
KRYEMINISTRI
Aleksandër Meksi

RESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha